



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 6

Rrogozhinë, më 23.06.2025 ora 10 : 00⁰⁰

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Mbajtja e këtij procesverballi është bërë në mënyrë të përmbledhur nga Sekretari i Këshillit dhe jo në mënyrën e zakonshme që bëhet transkriptimi fjalë për fjalë pasi për arsye të panjohura videoregjistrimit të mbledhjes i mungon audio, pra fjalët e këshilltarëve nuk dëgjohen. Për këtë arsye sapo mbledhja mbaron dhe kjo gjë u vërejt nga sekretari dhe punonjësja e IT-së u mbajt një procesverbal ku sqarohet situata e ndodhur. Gjithsesi materiali do të ruhet në arkivën e KB në rast se mund të ketë në të ardhmen mënyra nga specialistë të ndryshëm IT që mund të rikuperojnë audion.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës Njoftim, të thirrur nga Kryetarja e Këshillit Bashkiak, me shkresën Nr.2496.Prot datë 18.06.2025 me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverballit Nr.5, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.05.2025.
- 3- Për pranimin e Dorëheqjes nga mandati i këshilltarit të Z.Isa Halili.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%".
- 5- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2025 nga fondi i pushtetit vendor".
- 6- Projekt - vendimit, "Për Emërtimin e Disa Shesheve Rrugëve dhe Bulevardeve në qytet Rrogozhinë".
- 7- Raportim nga Njësitë Administrative.
- 8- Raport mbi punën e bërë Qershor 2024-Maj 2025 nga Drejtoria Juridike.
- 9- Informacion nga Drejtoria Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Turizmit.
- 10- Raport nga shefi MZSH-së.
(Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 26.05.2025).
- 11-Të ndryshme.



Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Lorena Baku, Sokol Gosa, Saimir Cani, Merilin Saraçi, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani, Mukades Gixhari, Erind Tosku.

Mungojnë :

Lije Dedej, Besnike Coraj, Shpati Kolgega, Mitat Daja, Altin Tosku.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
4. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
5. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
7. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
8. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
9. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vadijes.
10. Besnik Dushku - Shefi i MZSH-së.
11. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
12. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : 14 Këshilltarë, (Znj. Merilin Saraçi i bashkohet në vijim mbledhjes minuta e 6 e zhvillimit të mbledhjes) si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

HAPET MBLEDHJA



Mukades Gixhari . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje : z. Renato Kalemi, znj. Fatmira Thartori, z. Enver Memolla, znj. Alime Hoxha, z. Lulzim Hasa, znj. Gezime Met-hasani, znj. Lorena Baku, z. Sokol Gosa, z. Saimir Cani, z. Indrit Dedej, znj. Silvana Aliu, z. Hekuran Xhani, Mukades Gixhari, z. Erind Tosku.

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 27.05.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr . 15 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr . 16 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2025 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr . 17 . Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë.

-Kemi dhe Vendim nr . 18 . datë 27.05.2025 “ Për miratim Plan Masash “Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhet të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret”, i cili i është përcjellë Prefektit për verifikim ligjor pasi është konsideruar akt me karakter normativ dhe Prefekti shprehet që ky vendim konfirmohet në parim referuar ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe ligjit nr.57/2020 “Për pyjet” i ndryshuar.

Tani kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratimi i rendit të ditës. E hedhim në votim. Jemi dakord për miratimin e rendit të ditës? Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 14-vota pro, pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Pika 2, Miratim i procesverbalit Nr.5, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.05.2025. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 14-vota pro, pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 3. Kam këtu propozimin e Komisionit të Mandateve “Për pranimin e Dorëheqjes nga mandati i këshilltarit të z.Isa Halili”.

Hekuran Xhani . Nuk ka pse kalon me vendim fare le t’i përcillet KQZ direkt dorëheqja.

Ervis Shera . Për procedurë duhet pasi është pikërisht vendimi i këshillit që i përcillet KQZ-së.



Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim propozimin e Komisionit të Mandateve “Për pranimin e Dorëheqjes nga mandati i këshilltarit të z.Isa Halili”. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 14 (katërbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr.19. Miratohet me 14 vota pro, propozimi i bërë nga Komisioni i Mandateve për pranimin e dorëheqjes nga mandati i këshilltarit të z. Isa Halili, mbështetur dhe në kërkesën për dorëheqje të bërë nga vetë Këshilltari shkresa me Nr.2443.Prot datë 17.06.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës . Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2025 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Kemi 19 familje përfituese me fond rreth 69 mijë lekë të reja.

-Mbledhjes i bashkohet këshilltarja znj. Merilin Saraçi në minutën e 6-të, të zhvillimit të mbledhjes.

Mukades Gixhari . Mbledhjes ju bashkua znj. Merilin Saraçi. Atëherë meqë nuk ka diskutime e hedhim në votim pikën 4 të rendit të ditës. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr.20. Miratohet me 15- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2484.Prot datë 18.06.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2025 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%”, si dhe Relacionin Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2484/1.Prot datë 18.06.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2025 nga fondi i pushtetit vendor”. Relaton po drejtori z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Kemi 17-familje përfituese me fond rreth 81 mijë lekë të vjetra.



Mukades Gixhari . Atëherë meqë nuk kemi diskutime e hedhim në votim pikën 5 të rendit të ditës. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.21. Miratohet me 15- vota pro projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.2483.Prot datë 18.06.2025“Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2025 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2483/1.Prot datë 18.06.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6-të, të rendit të ditës. Miratim i Projekt - vendimit, “Për Emërtimin e Disa Shesheve Rrugëve dhe Bulevardeve në qytet Rrogozhinë”.

Silvana Aliu . Me kordinatoren e projektit BtF (Bashki të Forta) në një prej takimeve që kemi pasur me të na është thënë që duhen dy komisione që vlerësojnë kërkesat për dhënien e titujve të nderit njërin duhet ta ngrejë Kryetari i Bashkisë dhe tjetrin Këshilli Bashkiak, pra kërkoj ngritjen e këtij komisioni paraprakisht dhe zhvillimin e dëgjësave publike.

Orges Tosku . Dëgjesat nuk janë detyrim.

Hekuran Xhani . Unë të paktën për emërtimin e sheshit për z. Xhavit Halili përtej politikës jam shumë dakord që të nderohet dhe t’i vendoset ai emër për të tjerat pastaj kemi dhe këshilltarët nga Rrogozhina që të shprehen, parimisht jam dakord.

Enver Memolla . Për mendimin tim së pari projektvendimi duhet të vinte i ndarë dhe jo me tre propozime emërtimesh siç ka ardhur por të ishin tre projektvendime më vete.

Orges Tosku . Të tregoj një shembull të Bashkisë Tiranë që ka bërë 7 emërtime në një vendim.

Enver Memolla . Ta mbaroj të lutem. Unë nuk kam gjë më emrat por dhe komisioni duhet të ngrihet sipas sugjerimit të dhënë nga BtF. Tjetër a e keni verifikuar që mos ka emërtim tjetër rruga që të mos kemi përplasje dhe të mos na ndodhë situata si në Ballaj me emërtimin e rrugës së Bajazitit?

Orges Tosku . Nuk ka mbivendosje emrash.



Lulzim Hasa . Unë jam dakord me projektvendimin Xhavitin e kam njohur dhe e meriton të nderohet figura e tij.

Sokol Gosa . Unë jam dakord me dy emërtimet tjera vetëm me emërtimin e bulevardit "13 Nëntori" nuk jam dakord.

Silvana Aliu . Dakord këtë e kalojmë siç është por për propozimet tjera duhet të ngrejme komisionin me përbërje këshilltarësh.

Enver Memolla . Dakord por duhet të saktësojmë a do e shfuqizojmë komisionin e jashtëm që kemi ngritur për këtë qëllim?

Mukades Gixhari . Jeni dakord të ngrejme në vijim një komision vetëm me këshilltarë për vlerësimin e propozimeve për dhënien e titujve të nderit?

-Miratohet me 15-vota pro ngritja e një komisioni këshillimor për dhënien e titujve të nderit me përbërje vetëm këshilltarë.

Mukades Gixhari . Meqë nuk kemi më diskutime , e hedhim në votim pikën 6-të, të rendit të ditës. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 14 (katërmëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.

Vendim nr.22. Miratohet me 14-vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2412.Prot datë 13.06.2025 "Për emërtimin e disa shesheve, rrugëve dhe bulevardeve në qytetin Rrogozhinë", si dhe Relacioni Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2412/1.Prot datë 13.06.2025.

-Në votimin e pikës 6, Këshilltari z. Hekuran Xhani ndodhet jashtë sallës së Këshillit dhe nuk është llogaritur vota e tij.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 7. Raportim Nga Njësitë Administrative. Për Njësinë Administrative Lekaj raporton punonjësi i Njësisë Administrative z. Bashkim Greca. Për Njësinë Administrative Sinaballaj raportojnë punonjësit z. Qerim Tosku dhe z. Lutfi Hila.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 8, Raport mbi punën e bërë Qershor 2024-Maj 2025 nga



Drejtoria Juridike. Relaton Drejtoresha Juridike znj. Enkela Ballabani.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 9, Informacion nga Drejtoria Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Turizmit. Relaton Drejtori z. Orges Tosku.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 10, Raport nga shefi MZSH-së. Raporton z. Besnik Dushku.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 11 tek të ndryshmet, së pari kemi miratimin e propozimit të bërë nga dy kryetarët e grupeve për krijimin e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit për Bashkinë Rrogozhinë. Me këtë strukturë znj. Fatmira Thartori Kryetare, znj Silvana Aliu Zëvendëskryetare, z. Enver Memolla Anëtar, z. Indrit Dedej Anëtar, z. Lulzim Hasa Anëtar.

Hekuran Xhani . Si rregull kryetari i këtij komisioni na takon ne opozitës.

Silvana Aliu . Ky komision duhet të ketë kryetar të opozitës.

Fatmira Thartori . Unë jam dakord me ngritjen e këtij komisioni pasi komisioni i mëparshëm i jashtëm që ngritëm ne e ka humbur funksionin e tij pasi ka dy vjet që nuk angazhohe.

-Pas një diskutimi të gjatë mes këshilltarëve në lidhje me këtë propozim, pasi janë larguar nga mbledhja dhe këshilltarët z. Sokol Gosa, znj. Merilin Saraçi, znj. Alime Hoxha (ikën dhe vjen). Kryetarja e këshillit hedh në votim propozimin për krijimin e komisionit.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim propozimin për krijimin e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit për Bashkinë Rrogozhinë. Me këtë strukturë znj. Fatmira Thartori Kryetare, znj Silvana Aliu Zëvendëskryetare, z. Enver Memolla Anëtar, z. Indrit Dedej Anëtar, z. Lulzim Hasa Anëtar. Pro, kundër, abstenim?

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim projektvendimi i propozuar nga kryetarët e grupeve politike me Nr.2530.Prot datë 23.06.2025.

Vendim nr.23. Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga kryetarët e grupeve politike të këshilltarëve me nr.2530.Prot datë 23.06.2025 "Për ngrijen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit për bashkinë Rrogozhinë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Mukades Gixhari . Meqë nuk kemi më diskutime të tjera, mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Ju faleminderit.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 12 : 15⁰⁰ . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 02 orë ; 09 min ; 13 sek.
- Pjesë përbërëse e këtij procesverbali është dhe procesverbali mbi videoregjistrimin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 23.06.2025, të mbajtur nga sekretari i Këshillit dhe punonjësja e IT-së pranë Bashkisë znj. Sidorela Aliu pas mbarimit të mbledhjes së KB.

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 8 (tetë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2529 Prot.

Rrogozhinë, më 23.06.2025

**PROCESVERBAL MBI VIDEOREGJISTRIMIN E MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHAKIAK DATË 23.06.2025**

I mbajtur sot më datë 23 / 06/2025, në sallën e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë pas mbledhjes së Këshillit Bashkiak Rrogozhinë thirrur me Njoftimin e Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.2496.Prot datë 18.06.2025 në prezencën e z. Ervis Shera me funksion Sekretar i Këshillit Bashkiak Rrogozhinë dhe specialistes së IT-së punonjësës së Bashkisë Rrogozhinë znj, Sidorela Aliu.

Sa më lart pas përfundimit të mbledhjes së KB rreth orës 12:20, u vërejt një problematikë në regjistrimin e kësaj mbledhjeje që mungon regjistrimi audio, dmth figura është e qartë por zëri dhe çfarë është folur në mbledhje ndryshe nga regjistrimet e mëparshme në këtë videoregjistrim mungon. Arsytet nga punonjësja IT-së znj. Sidorela Aliu janë të paqarta gjithsesi materiali nga ana jonë do ruhet që nëse ka mënyra rikuperimi shpresojmë që të rifitojmë dhe zërin për këtë mbledhje. Theksojmë që punonjësja e IT-së znj. Sidorela Aliu regjistron dhe administron sistemin e videoregjistrimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak prej një periudhë prej rreth 3-vitesh dhe më parë një problematikë e tillë nuk ka ndodhur.

Ky procesverbal hartohet në tre kopje.

SEKRETARI I KËSHILLIT

ERVIS SHERA

PUNONJËSJA E IT-SË

SIDORELA ALIU



Nr. 2302 Prot.

Rrogozhinë, më 09.07. 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ dt. / / 2025

“Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2025 nga fondi i Bllok-Ndihmës 6%”

Spektori i Ndhmes Ekonomike dhe Komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkise me datë 15.07.2024 me Urdherin e Brendshem Nr.370 per verifikimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 date 17.12.2015 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”i ndryshuar. Sipas nenit 21 ligji Nr. 57/2019 date 10.03.2005 i ndryshuar me dt.07.12.2016, pika 13 parashikohet qe: “Keshilli Bashkiak ka te drejte te trajtoje me ndihme ekonomike familjet aplikuese te cilat nuk jane shpallur perfituese nga sistemi i pikezimit, bazuar ne vleresimin social-ekonomik te kryer nga administratori shoqeror keto familje do te trajtohen nga fondi i kushtezuar per bllok-ndihmen ekonomike deri ne 6% dhe /ose me fonde te buxhetit vendor. Menyra e dhenies se ndihmes ekonomike per familjet qe nuk jane shpallur perfituese nga sistemi i pikezimit, percaktohet me udhezim te Ministrit pergjegjes per ceshtjet sociale.

Këshilli i Bashkisë Rrogozhinë në mbledhjen e tij te rradhës

TE MIRATOJË:

1-Dhënien e Ndhmës Ekonomike për 17 familje sipas listës bashkengjitur këtij projektvendimi duke qënë se këta persona plotësojnë të gjitha kriteret juridike dhe ekonomike të miratuara në vendimin nr 3,dt 30.01.2025 të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për marrjen e Ndhmës Ekonomike.



2-Fondi total prej 65'459 leke

3-Këto familje trajtohen në një listë të vecantë me fondin e 6% të bllok Ndhmës-Ekonomike.

Lista që i bashkangjitet projektvendimit në total të familjeve të propozuara në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar.

Njësia Gosë	Shuma që përfitojnë
1-Latif Zenel Sokoli	3'703leke
2-Luman Ibrahim Murati	3'703leke
3-Nuri Zeber Deliu	3'703leke
4-Nexhip Qamil Sheshi	5'346leke
5-Qemal Shaban Sheshi	3'703leke
6-Atlije Ndrçim Huqi	5'940leke
7-Jeta Selim Bisku	5'445leke

Njësia Kryevindh	Shuma që përfitojnë
1-File Latif Osma	3'146leke
2-Luljeta Halit Leçini	3'960leke

Njësia Lekaj	Shuma që përfitojnë
1-Besim Sali Lecini	3'703leke



Njësia Rrogozhinë

Shuma që përfitojnë

1-Isa Fejzulla Tusku	3'703leke
2- Prandvera Irakli Andoni	2'178leke
3-Brunilda Sherbet Sina	3'960leke
4-Sami Qemal Memolla	6'732leke
5-Perparime Behar Cani	2'178leke
6-Shpetim Nuri Fejzo	2'178leke
7-Lindita Alush Kashari	2'178leke

Per komision

Ledian Hasani (Dr Mbrojtjes/Kujdesit Soc)

Dorina Macolli (Pergj NE/PAK/Strehim Soc)

Suela Proshka (Spec Ndihma Ekonomike)

KRYETAR I BASHKISE

Edison MEMOLLA

Në mungesë dhe me urdhër

N/KRYETAR
Andi PROSHKA

Andi PROSHKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA E MBROJTJES DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr. 2802¹¹ Prot.

Rrogozhinë, më 09.07.2025

RELACION

MBI PROJEKT – VENDIMIN, “PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR MUAJIN QERSHOR 2025 NGA FONDI I BLOK-NDIHMËS 6 %”

Të nderuar Këshilltarë ,

Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Komisioni i ngritur nga Kryetari i Bashkisë me datë 15.07.2024 me Urdherin e Brendshëm Nr.370 për verifikimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Ligjin Nr. 57/2019 datë 10.03.2005. Në ligjin Nr. 57/2019 datë 10.03.2005 i ndryshuar me dt.07.12.2016, pika 13 parashikohet që: “Keshilli Bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikezimit, bazuar në kriteret e miratuara me datë 30.01.2025 në vendimi 3 në Keshillin Bashkiak si dhe nga vlerësimi social-ekonomik i kryer nga administratorët shoqërorë të këtyre familjeve do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% dhe /ose me fonde të buxhetit vendor. Menyra e dhenies së ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikezimit, përcaktohet me udhëzim të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Referuar sa më sipër Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social së bashku me komisionin e ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.370 datë 15.07.2024 “Për verifikimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”, ju paraqet për shqyrtim dhe miratim këtë projekt-vendim ku në total për muajin Qershor 2025 janë 17 familje me fond prej 65`459 (gjashtëdhjetëpesemijë e katërqind e pesëdhjetëenente) lekë. Këto janë familje që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe do të trajtohen duke përdorur deri në 6% nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike, parashikuar në ligjin nr 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” udhëzimi nr 29/1 dt 13.01.2025. Masa e ndihmës ekonomike llogaritet në bazë të strukturës së familjes (pjesëtarëve në familje) sipas Udhëzimit të Ministrit “Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike” por



që nuk mund të jetë më e lartë se 8000 (tetë mijë) lekë në muaj. Në bazë të vlerësimit social-ekonomik të bërë në familje nga administratori shoqëror nëpër njësitë administrative dhe nga Komisioni i ngritur për këtë qëllim sipas rastit, po ju detajojmë si më poshtë kriteret të cilët plotësojnë këto familje për t'u kualifikuar dhe për të përfituar nga fondi i bllok ndihmës 6% për muajin Qershor 2025 si më poshtë:

Njësia Gosë

Shuma që përfitojnë

1-Latif Zenel Sokoli	3'703leke
2-Luman Ibrahim Murati	3'703leke
3-Nuri Zeber Deliu	3'703leke
4-Nexhip Qamil Sheshi	5'346leke
5-Qemal Shaban Sheshi	3'703leke
6-Atlije Ndriçim Huqi	5'940leke
7-Jeta Selim Bisku	5'445leke

Njësia Kryevindh

Shuma që përfitojnë

1-File Latif Osma	3'146leke
2-Luljeta Halit Leçini	3'960leke

Njësia Lekaj

Shuma që përfitojnë

1-Besim Sali Lecini	3'703leke
---------------------	-----------

Njësia Rrogzhinë

Shuma që përfitojnë

1-Isa Fejzulla Tusku	3'703leke
2- Prandvera Irakli Andoni	2'178leke
3-Brunilda Sherbet Sina	3'960leke



4-Sami Qemal Memolla	6'732leke
5-Perparime Behar Cani	2'178leke
6-Shpetim Nuri Fejzo	2'178leke
7-Lindita Alush Kashari	2'178leke

Sipas rregullave të ndjekura nga ligji nr 57/2019 ndryshuar me date 26.012.2024 nr vendimi 855 për Asistencën Sociale Në Republikën e Shqipërisë familjet e sipërlistuara kanë kaluar nga faza e aplikimit në sistem si familje në nevojë dhe nga vlerësimi i sistemit nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbime Sociale Tiranë kanë rezultuar jo përfituese për mungesë pikësh. Kësisoj duke nisur nga kushtet ekonomike dhe pamundësia për tu përzzgjedhur përfituese në NE janë rekomanduar në sistem që të trajtohen nga bllok fondi i kushtëzuar i Ndhmës Ekonomike. Sipas nenit 27 të këtij ligji të gjitha familjet përfituese të NE dhe të 6% i janë nënshtruar kontrollit për përdorimin e fondeve të ndihmës ekonomike nga organet e specializuara si Drejtoria Rajonale e shërbimit Social Tiranë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTORI I MBROJTJES DHE KUJDESIT SOCIAL
LEDIAN HASANI

REPublika e Shqipërisë

BASHKIA RROGOZHINË

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Nr. 2801 Prot.

Rrogozhinë, më 09/07/2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë / / 2025

"Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2025 nga fondi i pushtetit vendor"

Komisioni I ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr 84 datë 13.02.2023 nga Kryetari I Bashkisë "Për verifikimin e familjeve që jetojnë në gjendje të vështirë ekonomike", mbështetur në Ligjin Nr 139 datë 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" VK B nr. 64 ,dt.23.12.2024 "Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025", Ligjin Nr. 10296 ,datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" Udhëzimi Nr.2 datë 06.02.2012 "Për Proçedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit", të nenit 21 ,të Ligjit Nr. 57/2019 ,datë 18.07.2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" ,Vkm nr.597 ,date 4.9.2019 " Për përcaktimin e proçedurave ,të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfutimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike Vendimit të Këshillit Nr. 03 ,datë 27.01.2020 "Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë financiare me fondet e buxhetit vendor nga Bashkia Rrogozhinë".

Keshilli i Bashkisë Rrogozhinë në mbledhjen e tij të rradhes

TE MIRATOJE:

- 1-Dhënien e Ndihmës Ekonomike për 13 familje sipas listës bashkengjitur këtij projekt vendimi duke qënë se këta persona plotësojnë të gjitha kriteret për marrjen e Ndihmës Ekonomike,
 - 2-Fondi total prej 66 652 leke
 - 3-Këto familje trajtohen në një listë të vecantë me fondin Ndihma Ekonomike të Bashkisë Rrogozhinë të vitit 2025 (Llogaria 606-1004) .
- Lista që i bashkangjitet projektvendimit në total të familjeve të propozuara në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin

Emër Atësi Mbiemër	Shuma	Nr.identifikimit	Vendbanimi
I.Vaid Mesar Sinameta	3703 lekë	F10206019G	Rrogozhinë

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email: brrogozhine@gmail.com



2. Erjon Dritan Livanaj	5881 lekë	K21129032P	Kryevindh
3. Etleva Gezim Xhafa	5881 lekë	I55310191V	Rrogozhinë
4. Nafije Qemal Saraçi	4792 lekë	G15909019H	Gosë
5. Manushaqe Sali Menalla	4792 lekë	H45531032V	Gosë
6. Nadire Muhamet Deda	3703 lekë	F56208017Q	Rrogozhinë
7. Alberta Astrit Xhafa	5881 lekë	K05729045B	Rrogozhinë
8. Nusret Sulejman Sheshi	5881 lekë	I20530046V	Gosë
9. Marjeta Astrit Xhafa	5881 lekë	J36012046W	Rrogozhinë
10. Ardiana Xhavit Hoxha	5881 lekë	H46223031M	Rrogozhinë
11. Elisa Arti Feti	4792 lekë	K05202043T	Gosë
12. Manola Syrja Serjani	3703 lekë	H45608040P	Gosë
13. Arjan Astrit Kashari	5881 lekë	I80410068A	Rrogozhinë

Komisioni
Ledian Hasani
Dorina Maçolli
Manjola Gjuzi


KRYETAR

Edison MEMOLLA

Në mungesë dhe me Urdhër

N/kryetar

Andi Proshka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Nr. 28011 Prot.

Rrogozhinë, më 07/07/2025

Relacion shpjegues për projekt-vendimin e dhenies të ndihmes ekonomike nga fondet e pushtetit vendor për muajin Korrik 2025.

Drejtuar: Këshillit Bashkisë Rrogozhinë.

Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2025 nga fondi i pushtetit vendor ”

Komisioni Ingridur me Urdhërin e Brendshëm Nr 84 datë 13.02.2023 nga Kryetari i Bashkisë “Për verifikimin e familjeve që jetojnë në gjendje të vështire ekonomike ” ,mbështetur në Ligjin Nr 139 datë 17.12.2015 “Për Veteqeverisjen Vendore” VK B nr. 64 ,dt.23.12.2024 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025” ,Ligjin Nr. 10296 ,datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Udhëzimi Nr.2 datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, të nenit 21 ,të Ligjit Nr. 57/2019 ,datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” ,Vkm nr.597 ,date 4.9.2019 “ Për përcaktimin e procedurave ,të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike Vendimit të Këshillit Nr. 03 ,datë 27.01.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë financiare me fondet e buxhetit vendor nga Bashkia Rrogozhinë”.

1-në total janë 13 familje për muajin Korrik 2025 ,familje që plotësojnë kriteret dhe dokumentacionin për përfitimin e ndihmës ekonomike mbështetur në Vendimit të Këshillit Nr. 03 ,datë 27.01.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë financiare me fondet e buxhetit vendor nga Bashkia Rrogozhinë”

2-Fondi total prej 66 652 leke parashikuar në VK B nr. 64 ,dt.23.12.2024 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025”.

3- Këto familje trajtohen në një listë të vecantë me fondin Ndihma Ekonomike të Bashkisë Rrogozhinë të vitit 2025 (Llogaria 606-1004) .

13 familjet janë të kategorive si më poshtë.

- | | |
|-------------------------|--|
| 1. Vaid Mesar Sinameta | 3703 lekë (f. me të ardhura të pamjaftueshme) pika 2 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020 |
| 2. Erjon Dritan Livanaj | 5881 lekë (f. me të ardhura të pamjaftueshme) pika 2 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020 |
| 3. Etleva Gezim Xhafa | 5881 lekë (f. në varfëri ekstreme) pika 8 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020 |
| 4. Nafije Qemal Saraçi | 4792 lekë (f. me të ardhura të pamjaftueshme) pika 2 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020 |



5. Manushaqe Sali Menalla	4792 lekë (f. me të ardhura të pamjaftueshme) pika 2 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020
6. Nadire Muhamet Deda	3703 lekë (f. me të ardhura të pamjaftueshme) pika 2 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020
7. Alberta Astrit Xhafa	5881 lekë (f. në varfëri ekstreme) pika 8 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020
8. Nusret Sulejman Sheshi	5881 lekë (f. me të ardhura të pamjaftueshme) pika 2 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020
9.Marjeta Astrit Xhafa	5881 lekë (f. në varfëri ekstreme) pika 8 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020
10.Ardiana Xhavit Hoxha	5881 lekë (f. me të ardhura të pamjaftueshme) pika 2 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020
11.Elisa Arti Feti	4792 lekë (f. me të ardhura të pamjaftueshme) pika 2 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020
12.Manola Syrja Serjani	3703 lekë (f. me të ardhura të pamjaftueshme) pika 2 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020
13.Arjan Astrit Kashari	5881 lekë (f. me të ardhura të pamjaftueshme) pika 2 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020

Janë vlerësuar kushtet e familjes nga komisioni I ngritur pika 9 e Vkb nr 03 dt.27.01.2020 gjithashtu janë bërë llogaritjet sipas Udhëzimit nr.4, datë 17.02.2017 "Për llogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike".

DREJTORI I MBROJTJES DHE KUJDESIT SOCIAL

LEDIAN HASANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

DREJTORIA E MBROJTJES DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr. 238³ Prot.

Rrogozhinë, më 08.07 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. __ dt / / 2025

“Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi

“Subvencionimi i Interesave të Kredisë për vitin 2025”

Duke u mbështetur të ligjit nr.139\2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Ligjin nr.22\2018 “Për Strehimin Social” neni nr 16, VKM Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për të përfiruar strehim sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr. 453, date 3.7.2019 Per masen e Subvencionimit të interesave të Kredisë dhe Procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti. Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.4 datë 30.01.2025” Për krijimin e komisionit për programet e Strehimit Social”. Vendimin e këshillit Bashkiak nr.60, datë 23.12.2024 “Per miratimin e sistemit të pikëzimit për programin “Subvencioni I interesave të kredisë ” Urdhërit të Brëndshëm nr. 68 datë 17.02.2025 ngritur nga Kryetari I Bashkisë Rrogozhinë “Për krijimin e komisionit për programin e strehimit social, subvencionim I interesave te kredise për vitin 2025”, shkresës me Nr. 15406 Prot datë 06.12.2024 ardhur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me 8 kuota, shkresës me Nr.15406/2 datë 16.01.2025 ardhur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për kuotat e lira nga program I subvencionim I interesave të kredive nga viti 2019 apo nga viti 2022.

Të vendosë:

Miratimin e listës përfituese të aplikantëve nga programi “SUBVENCIONI I INTERESAVE TE KREDISE PER VITIN 2025” për familjet e pastreha si më poshtë vijon tabela.

Nr	Data e aplikimit	Aplikanti	Pikë
1	05.06.2025	Mirvan Bardhi Daja	13
2	21.05.2025	Elis Xhemal Kacani	13
3	05.06.2025	Edio Artan Kasa	13
4	27.05.2025	Emanuel Vladimir Dushi	13
5	28.05.2025	Nertila Rexhep Proshka	13
6	26.05.2025	Altin Shefit Thartori	8
7	26.05.2025	Antonio Nazmi Dermaku	8
8	05.06.2025	Jona Jonuz Gjoka	8

Komisioni

1. Ledian Hasan
2. Rezart Vogli
3. Luan Gjuzi
4. Ismail Broli
5. Nazmi Cela
6. Entela Xhafa
7. Gjergj Mustafaj



Adresa: Bashkia Rrogzhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavaiës. Blloku "12 Shtatori" Email: brrrogzhina@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Nr. 2783 / 1
Prot.

Rrogozhinë, më 08/07 /2025

Relacion shpjegues për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Rrogozhine për

Lënda: "Për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programi

"Subvencionimi i Interesave të Kredisë për vitin 2025"

E nderuar Kryetare e Këshillit Bashkiak,

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Duke u mbështetur të ligjit nr.139\2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", Ligjin nr.22\2018 "Për Strehimin Social" neni nr 16, VKM Nr.384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për të përfiruar strehim sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr. 453, date 3.7.2019 Per masen e Subvencionimit të interesave të Kredisë dhe Procedurën e dhënies së tij për familjet që perfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti. Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.4 datë 30.01.2025" Për krijimin e komisionit për programet e Strehimit Social ".Vendimin e këshillit Bashkiak nr.60, datë 23.12.2024 "Per miratimin e sistemit të pikëzimit për programin "Subvencioni i interesave të kredisë " Urdhërit të Brëndshëm nr. 68 datë 17.02.2025 ngritur nga Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë "Për krijimin e komisionit për programin e strehimit social, subvencionim i interesave të kredisë për vitin 2025", shkresës me Nr. 15406 Prot datë 06.12.2024 ardhur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me 8 kuota, shkresës me Nr.15406/2 datë 16.01.2025 ardhur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për kuotat e lira nga program i subvencionim i interesave të kredive nga viti 2019 apo nga viti 2022.

"Bashkia Rrogozhine prej vitit 2019, ka rreth 33 kuota, në të gjithë këtë periudhë janë kualifikuar 16 familje përfituesish sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak nr 33 datë 03.04.2020, nr 36 datë 25. 06. 2021 dhe nr 53 datë 24.09.2021 për miratimin e familjeve përfituese për të përfituar kredi të lehtësuara për Strehim. Ne total nga viti 2020-2024 nga 16 familje përfituese vetëm dy familje janë financuar nga Bankat, gjithashtu për vitin 2025 janë shpallur fituese 8 familje me vendim nr.11, datë 20.03.2025 të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë. Gjithsej kemi 23 kuota të lira.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1 Rruga e Kuvendit Bashkiak Rrogozhinë

Një formulë pikëzimi me 100 pikë në total është përdorur për secilin aplikues . Ata që mbledhën më shumë pikë u përzgjedhën bazuar në kriteret ekonomike, familjare, kushtet e strehimit dhe kushtet sociale.

Aplikimi për të përfituar nga subvencionimi i interesave të kredisë , u bë me dy faza. Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga ky program, sipas ligjit nr. 22/2018. Ndërsa në fazën e dytë të aplikimit u përfshihe vetëm ata/individë/familje që plotësojnë kushtet për t'u trajtuar me këtë program .Pas komisionit të datës 03.07.2025 dhe me vlerësimet e bëra prej tij vendoset lista e përfituesve si më poshtë.

Lista e përfituesve.

Nr	Data e aplikimit	Aplikanti	Pikë
1	05.06.2025	Mirvan Bardhi Daja	13
2	21.05.2025	Elis Xhemal Kacani	13
3	05.06.2025	Edio Artan Kasa	13
4	27.05.2025	Emanuel Vladimir Dushi	13
5	28.05.2025	Nertila Rexhep Proshka	13
6	26.05.2025	Altin Shefit Thartori	8
7	26.05.2025	Antonio Nazmi Dermaku	8
8	05.06.2025	Jona Jonuz Gjoka	8

Pavarësisht zbatimit me sukses të këtij programi ka ende kuota të lira. Programi i strehimit social "Subvencionimi i interesave të kredisë" u shërben familjeve ose individëve që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore. Prioritet u jepet çifteve të reja, grave kryefamiljare apo individëve e familjeve të minoritetit rom e egjiptian.

Drejtori i Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Ledian Hasani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Nr. 2494 Prot.

Rrogozhinë, më 19.06.2025

Projekt-vendim

“Per miratimin e taveve perfundimtare te Programit Buxhetor Afatmesem te Njesise se Vetqeverisjes Vendore Bashkia Rrogozhine”

Ne perputhje me nenet 4 dhe 24 te Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise” te ndryshuar, ligjit nr.68, date 27.04.2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”, te ndryshuar dhe udhezimit nr.23 ,date 30.07.2018 “Per procedurat standarte te programit buxhetor afatmesem te njesie te vetqeverisjes vendore” te ndryshuar, Bashkia Rrogozhine propozon:

Te vendosi:

1. Te miratoje Tavanet perfundimtare te Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028.
2. Me miratimin e Taveve Buxhetore Afatmesem ,Bashkia Rrogozhine fillon nga puna per pergatitjen perfundimtare te PBA 2026-2028.
3. Ngarkohet per zbatimin e ketij vendimi GMS ne Bashkise Rrogozhine.



Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email: brrogozhine@gmail.com

Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA

NJVQV: 119 - Bashkia Rrogozhinë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2026	2027	2028
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi			
Shpenzime Personeli (600-601)	214,560	216,272	294,197
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	41,890	42,267	98,880
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	80,437	74,883	222,342
Tavanet e Përgjithshme	336,887	333,423	615,419
03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile			
Shpenzime Personeli (600-601)	18,385	18,550	22,489
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	15,207	16,677	6,710
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	10,000	12,000	6,701
Tavanet e Përgjithshme	43,592	47,227	35,900
04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit			
Shpenzime Personeli (600-601)	4,803	4,846	5,300
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	15,187	17,588	12,500
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	10	10	0
Tavanet e Përgjithshme	20,000	22,444	17,800
05100 - Menaxhimi i mbetjeve			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	16,608	16,757	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	18,798	18,798	0
Tavanet e Përgjithshme	35,406	35,555	0

Sekretari i GMS: REZART VOGLI

Koordinator i GMS: ANDI PROSHKA

Kryetari i GMS: EDISON MEMOLLA

Projekt Dokumenti i PBA 2026-2028 – Version Pune (Draft) (Faza I).

Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA

NJVQV: 119 - Bashkia Rrogozhinë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2026	2027	2028
06260 - Shërbimet Publike Vendore			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
